



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201502421/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit të kryer prej muajit Shtator 2008-Nëntor 2012, ndaj shtetasit I.S.*

**Drejtuar :** **Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike**  
Administratorit, z. Adrian ÇELA,

**Për dijeni:** **Entit Rregullator të Energjisë Elektrike**  
Kryetarit, z. Petrit AHMETI

**TIRANË**

*I nderuar z. Çela,*

Ashtu sikundër jeni vënë në dijeni me shkresën nr. K3/I113-2 prot, datë 06.04.2016, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi I. S., në të cilën ankohet ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lidhur me faturimin e padrejta dhe nxjerrjen debitor të energjisë elektrike për kontratën me nr. F – 91105.

Konkretisht, ankuesi pretendon se në muajin Korrik 2007, ka kërkuar anulimin e kontratës dhe ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për një apartament në Fushë-Arrëz, për shkak të ndërrimit të vendbanimit, por pas 1 viti ka konstatuar se ka vijuar faturimi, madje me konsum për energjinë elektrike në mënyrë të padrejtë.

Ankuesi sqaron se në mënyrë të vazhdueshme<sup>1</sup>, i ka kërkuar Departamentit të Faturimit, anulimin e faturave për periudhën Shtator 2008 - Nëntor 2012, por, rezulton se është anuluar vetëm një faturim në muajin Shkurt 2010, ndërkohë faturimet e tjera vijnë të llogariten me kamatëvonesa.

Për t'i ardhur në ndihmë qartësimi dhe konkretizimi të përmbajtjes së kësaj ankese kemi kërkuar një informacion pranë Operatorit të Shpërndarjes së

<sup>1</sup> Shkresa me nr. 142 prot., datë 16.01.2013, drejtuar OSHEE nga ana e z. Ilmi Sadria e në vijim

Energjisë Elektrike lidhur me shkaqet e anulimit vetëm të faturimit në muajin Shkurt 2010, ndërkohë që korrektimi duhet të përfshinte edhe periudhën Shtator 2008 – Nëntor 2012.

Referuar ankesës së mësipërme, me shkresën nr. 142 prot, datë 16.01.2013, nga ish Kompania CEZ Shpërndarje sh.a jemi vënë në dijeni se po merren masa për anulimin e faturimit të kryer në periudhën Shtator 2008-Nëntor 2012 si dhe gjendja të fiksohet në sasinë prej 13050 kwh energji elektrike.

Ndërkohë që pas riverifikimit të kësaj ankese mbi masat që po ndërmerren për zgjidhjen efektive të kësaj ankese me shkresën nr. 6664 /1 prot, datë 04.05.2016, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike jemi vënë në dijeni se:

*“Gjatë historikut të faturimit vëmë re se abonenti për periudhën Janar 2007-Shtator 2008 është faturuar me konsum progresiv në matje, në muajin Dhjetor 2009 dhe Janar 2010 është faturuar me tarifë shërbimi konsum 0.*

*Në muajin Shkurt 2010, abonenti është faturuar një konsum prej 1000 kwh, më pas ka vijuar të faturohet me tarifë konsumi 0. Konsumin e faturimit për periudhën Janar – Shtator 2007, abonenti e ka paguar në mënyrë periodike, ndërsa për periudhën Tetor 2007- Mars 2016 nuk është shlyer asnjë faturë.*

*Në bazë të proces-verbalit të verifikimit të mbajtur në objekt në datë 15.05.2015, nga grupi i punës që mbulon zonën e abonentit, ka rezultuar se matësi me nr.serial 31328 nga pamja vizuale i rregullt është me gjëndje 13259 kwh. Referuar sistemit të faturimit, faturat e muajit Shkurt 2010 është zbritur nga sistemi duke sistemuar kontratën e mëparshme, në muajin Mars 2016 leximi është 13259 kwh energji elektrike. Nisur nga sa më sipër konstatojmë se abonenti faturohet sipas leximit korrekt të sistemit të matësit”.*

*I nderuar z. Drejtor,*

Institucioni i Avokati të Popullit duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi si dhe duke konstatuar një qendrim kontradiktor zyrtar të mbajtur nga ana juaj në trajtimin e kësaj ankese, kërkon të sjellë në vëmendjen tuaj se këto veprime kanë ardhur në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht:

Duke ju referuar historisë së faturimit të këtij abonentit (provuara me dokumentacionin përkatës), rezulton se ky abonent sipas një vërtetimi të lëshuar nga Bashkia Fushë-Arrëz (gjendja civile), është transferuar nga kjo bashki për në Komunën Paskuqan (sot Njësia Administrative Paskuqan), në regjistrin 5 fleta 43 më datë 25.07.2007.

Gjithashtu, në datë 20.07.2007, abonenti ka paraqitur një kërkesë pranë Ndërmarrjes Elektrike – Fushë Arrëz (sot Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike) në të cilën ka parashtruar kërkesën për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike për shkak të transferimit të vendbanimit në Tiranë. Mbi këtë kërkesë është vënë në dijeni edhe personi përgjegjës i kësaj zone, i cili ka bërë edhe shkëputjen e energjisë elektrike nga banesa.

Gjithashtu, duke ju referuar korrespondencës zyrtare dhe verifikimeve konkrete në vend konkretisht, në datë 21.06.2013, gjendja e matësit në momentin e verifikimit ka rezultuar në sasinë prej 13259 kwh, e njëjta sasi energjie e konstatuar edhe nga ana juaj pas 3 vitesh në muajin Mars 2016.

Kjo sasi energji elektrike e pandyshuar, provon lehtësisht faktin se abonenti prej vitesh nuk merr furnizim me energji elektrike dhe referuar kërkesës së tij, si dhe ankesave të vazhdueshme pranë OSHEE prej vitit 2007, duhet të ishin ndërmarrë masa për ndërprerje të faturimeve përkatëse.

Nga kontaktimet e mësipërme trajtimi i kësaj ankese nga ana juaj është në paligjshmëri dhe në dëm të interesave të ligjshme të këtij konsumatori, i cili prej vitesh është endur dyerve të zyrave të kësaj kompanie, duke i shkaktuar jo vetëm dëm ekonomik, por edhe dëm moral për gjithë periudhën e gjatë të moszgjidhjes së kësaj ankese.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit është i detyruar t'ju kujtojë se ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit me energji elektrike është nënshkruar një kontratë furnizimi me energji elektrike, sipas të cilës në nenin 5 është parashikuar e drejta për pezullimin dhe përfundimin e Kontratës.

Në këtë nen citohet se Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

*5.1. Me kërkesë të Klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 5.2 e në vijim.*

*5.2. Nëse Klienti kërkon të ndërpresë Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike, ai do të njoftojë me shkrim Furnizuesin 30 ditë kalendarike përpara, dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet përkundrejt Furnizuesit.*

*Klienti nuk është përgjegjës për detyrimet ndaj Furnizuesit pas kalimit të afatit të mësipërm.*

*5.3. Sipas të njëjtave përcaktimeve Klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij. Furnizuesi do të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim. Klienti do të bëjë kërkesë për rilidhjen e energjisë pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit.*

*5.4. Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, Furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e lidhjes, Furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e shkëputjes, duke përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*5.5. Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e përfundimit të kontratës.*

Pra, duke qenë se abonenti ligjërisht ka kërkuar pezullim të kontratës së energjisë elektrike dhe është provuar që nuk merrte/merr furnizim me energji elektrike, nga ana juaj duhet të ishte ndërprerë faturimi për konsum energjie (megjithëse provohet që nuk ka konsum) dhe të faturohet vetëm për tarifat e shërbimit.

Për sa më sipër, nga ana juaj jo vetëm që nuk janë marrë masat brenda afateve ligjore për anulimin e këtyre faturimeve, megjithëse sipas shkresës nr. 142 prot datë 16.01.2013 të ish Kompanisë CEZ Shpërndarje këto faturime duhet të ishin anuluar për periudhën Shtator 2008-Nëntor 2012, konstohet se jo vetëm nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i mëtijshëm, por është rritur edhe vlera e debisë për këtë faturim të padrejtë.

Sa më sipër për të gjithë këto konstatime, institucioni i Avokatit të Popullit nisur nga qëllimi i mirë për përmirësimin e punës në funksion të mbrojtjes së interesave të ligjshme të konsumatorëve si dhe zgjidhjen ligjore të këtij problemi, e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim për të kontribuar së bashku për vënien në vend të të drejtës së shkelur ndaj shtetasit Ili Sadria.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me Neni 63/3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”, si dhe në bazë të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse), ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

#### **REKOMANDOJMË:**

***Marrjen e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit të kryer prej muajit Shtator 2008- Nëntor 2012 ndaj shtetasit I. S.***

Në bazë të nenit 22 të ligjit Nr.8454/1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na ktheni përgjigje të argumentuar brenda 30 ditëve, lidhur me qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERE**

**Etilda GJONAJ (SALIU)**